



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1134/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor, Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së rivotimit për raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura më datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, me shenjën ZL.Anr.1134/2017, të datës 18.12.2017, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së rivotimit për raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut, të mbajtura më datë 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1134/2017 me datën 18.12.2017, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, në të cilën pretendon se pas raportimit në media të raportit të organizatës Demokracia në Veprim (DnV), ka kërkuar nga PZAP-i, që të heton të gjitha të gjeturat e këtij raporti për shkak të rezultatit të ngushtë të votave në mesë të kandidatëve.

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore edhe provave të bashkangjitura në ankesë gjeti se parashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Paneli vlerëson se shkimi i shkruar në portalin Express lidhur me të gjeturat në procesin e votimit në Komunë e Istogut gjatë ditës së votimit me dt.17.12.2017 nga Demokracia në Veprim (DNV) nuk paraqet provë në bazë të së cilës mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me shkelje të cilat minojnë integritetin e zgjedhjeve. Po ashtu Demokracia në Veprim

ndonëse ka qenë e certifikuar për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe e njëjta ka mundur të paraqes në PZAP të gjeturat-shkeljet përmes ankesës, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, andaj raportimet e publikuara në media nuk mund të merren si prova në bazë të cilave mund të vendoset se ka pasur parregullsi.

Për më tepër parashtruesi i ankesës nuk i ka plotësuar asnjë kusht ligjor që kërkohet me dispozitë ligjore të nenit 5 paragrafi 7 pika c e Rregullës nr.02/2015 të PZAP-së, në të cilën përcaktohet se : “ Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzimet se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit”.

Prandaj paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 7 pika c e Rregullës nr.02/2015 të PZAP-së. Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave, dëshmive konkretë si dhe mungesës së udhëzimeve se ku mund të gjenden dëshmitë ankesën e ankuesit e refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 115, 117 dhe 118 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.1134/2017 më datën 19.12.2017.

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*